



- SALSTAT -

NR. 5

BULETIN INFORMATIV

STATISTIKA TË FORTA VENDORE SHQIPTARE

Projekti "Strong Albanian Local Statistics" (Për Statistika të Forta Vendore Shqiptare, SALSTAT) është pjesë e projektit "Bashki të Forta", financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) për periudhën gusht 2018-gusht 2022. Projekti "Bashki të Forta" punon për zhvillimin dhe decentralizimin e qeverisjes vendore në Shqipëri.

Tri palët kyçe të interesit në këtë projekt janë INSTAT-i, bashkitë, si dhe disa ministri të linjës dhe agjenci qeveritare, veçanërisht ato që kanë për detyrë mbledhjen e të dhënave statistikore zyrtare dhe/ose janë përgjegjëse për të dhënat/regjistrat administrativë.

INSTAT-i është partneri kyç i projektit SALSTAT. Ministritë e linjës dhe bashkitë janë partnere thelbësore pasi ato do të jenë, si përdorueset, ashtu edhe prodhueset e të dhënave për statistikat vendore dhe rajonale.

Përmbajtja:

- Shpërndarja e Vjetarit Statistikor Rajonal 2021
- Regjistri Statistikor i Ndërtesave dhe Banesave dhe Regjistri i Popullsisë dhe Familjeve
- Trajnim për stafin e INSTAT-it mbi metodologjitë e reja të anketimeve
- Seminare për fazën 2 të projektit SALSTAT
- Trajnimet e ardhshme për vitin 2022

Shpërndarja e Vjetarit Statistikor Rajonal

Vjetari Statistikor Rajonal, 2021 është botuar më 20 dhe 24 dhjetor 2021, në gjuhën angleze dhe shqipe. Më poshtë mund të gjeni linqet përkatëse:

<http://www.instat.gov.al/en/publications/books/2021/regional-statistical-yearbook-2021/>

<http://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2021/vjetari-rajonat-statistikor-2021>

Ekipi i SALSTAT-it së bashku me stafin e INSTAT-it ka organizuar takime në bashki të ndryshme gjatë periudhës shkurt – mars 2022 për të promovuar dhe diskutuar rreth aktiviteteve në lidhje me bashkitë si dhe për të konstatuar nevojat e ardhshme për një fazë të dytë të mundshme të projektit SALSTAT për periudhën 2022 - 2026. Gjatë takimit u diskutuan temat e mëposhtme:

- Vjetari Statistikor Rajonal 2021, në anglisht dhe shqip – Përmbajtja dhe rëndësia e treguesve të ndarë në nivel rajonal dhe vendor;
- Projekti SALSTAT në kuadër të mbështetjes së INSTAT-it nga qeveria zvicerane dhe përmirësimin e të dhënave vendore;
- Qëndrueshmëria e stafit të bashkive të trajnuar në kuadër të SALSTAT dhe trajnime të vazhdueshme
- Nevojat dhe kërkesat e përfaqësuesve bashkiakë
- Treguesit statistikorë të Bashkive
- CENSI - Rëndësia dhe lidhjet e komisioneve në nivel bashkiak.

Në këtë takim, përfaqësuesit bashkiakë ishin kryesisht kryetarë ose nënkryetarë të bashkive përkatëse, të cilët shprehën gatishmërinë për të vazhduar bashkëpunimin me INSTAT dhe projektin SALSTAT.

Rezultatet:

- Interesi dhe kërkesa kryesore e bashkive ndaj INSTAT dhe SALSTAT lidhej me publikimin e statistikave zyrtare në nivel bashkie.
- Bashkitë shprehën gatishmërinë e tyre për të nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me INSTAT-in. Aktualisht INSTAT po punon për një version paraprak. Për bashkitë ishte e rëndësishme që marrëveshja t'u japë atyre mundësinë jo thjesht të dorëzojnë të dhëna pranë INSTAT-it, por të marrin statistika dhe të dhëna nga INSTAT-i sipas nevojave përkatëse.
- Bashkitë shprehën mirënjohjen për mbështetjen e dhënë stafit të tyre në ngritjen e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve dhe shprehën problemin në lidhje me stafin që jep dorëheqje dhe largohet nga puna (orientim i rregullt). Për këtë arsye, ata kërkuar një mbështetje të vazhdueshme me trajnime për stafin e tyre, veçanërisht të atyre që ofrojnë dhe përdorin të dhëna dhe statistika.
- Disa bashki të vogla dhe të mesme ndanë lajmin se strukturës së tyre i kanë shtuar staf të dedikuar, përgjegjës për qëllime statistikore.
- Bashkitë shprehën mirënjohjen për trajnimin e mbetjeve të ngurta urbane për stafin përgjegjës që punon në mbledhjen e këtyre të dhënave; pritshmëritë dhe nevojat e tyre janë që të kenë mbështetje të vazhdueshme në këtë fushë, pasi një pjesë e stafit lëviz si dhe presin të publikohen të dhëna zyrtare statistikore për mbetjet në nivel bashkie.
- Tematika e trajnimeve të kërkuara ishte në lëndët që kanë të bëjnë me statistikën si përdorues dhe ofrues të të dhënave.
- Gjatë diskutimeve në lidhje me CENSIN e ardhshëm që do të realizohet në muajt tetor – nëntor 2022, u theksua rëndësia e këtij procesi për inventarizimin e të dhënave për disa aktivitete të rëndësishme të SALSTAT/INSTAT si: shpërndarja e të dhënave të bashkisë (duke përfshirë panelin kryesor), Regjistri i Ndërtesave dhe Banesave, dhe Regjistri i Popullsisë dhe Familjeve.
- Bazuar në diskutimet me bashkitë mbi nevojat dhe kërkesat e tyre, këto elemente kanë qenë një kontribut i rëndësishëm për hartimin e projekt dokumentit për fazën II të SALSTAT.



Regjistri Statistikor i Ndërtesave dhe Banesave dhe Regjistri i Popullsisë dhe Familjeve



Pas finalizimit të dokumentit konceptual për një Regjistër të mundshëm Statistikor Shqiptar të Ndërtesave dhe Banesave (RSShNB), eksperti i Zyrës Federale Zvicerane të Statistikave po punon së bashku me INSTAT për hapat e mëtejshëm drejt një plani të hollësishëm zbatimi.

Gjatë vizitave të tij pranë INSTAT gjatë muajve tetor 2021 - shkurt 2022, eksperti punoi ngushtë me INSTAT-in për modelin e të dhënave RSShNB dhe listën e variablave për të qenë gati për zbatimin e bazës së të dhënave me të dhënat pilot të censit dhe afatin kohor të aktiviteteve për zbatimin e


RSShNB-së.



Gjithashtu, një ekspert nga Zyra e Statistikave të Vendeve të Ulëta ka nisur të punojë së bashku me INSTAT për vlerësimin e hartimit të një projekt dokumenti për një Regjistër të mundshëm të Popullsisë dhe Familjeve në Shqipëri.

Trajnim për stafin e INSTAT-it mbi metodologjitë e reja të anketimeve

Gjatë datave 24 – 28 janar 2022 u zhvillua trajnimi i kursit “Statistics R” në kuadër të projektit SALSTAT. Trajnimi u zhvillua online (nëpërmjet sistemit Microsoft Teams) nga një ekspert nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Zvicrës Veriperëndimore (FHNW). Në trajnim morën pjesë 13 persona nga INSTAT dhe një përfaqësues nga Qendra Kombëtare e Biznesit.



Në fund të trajnimit pjesëmarrësit ishin në gjendje të:

- Instalojnë paketat R dhe R
- Përdorin R-GUI bazë si dhe skriptin R
- Përdorin R-Studio IDE dhe të shkruajnë raporte me R-markdown
- Trajtojnë të dhëna me R (Input, Output, Përgatitja e të Dhënave)
- Eksplorojnë të dhëna me R, sidomos në vizualizimin e të dhënave
- Zbatojnë metodën standarde deduktive të statistikave me R

Seminare për fazën 2 të projektit SALSTAT

Gjatë datave 8 – 10 mars, SALSTAT zhvilloi një grup seminaresh me të gjitha drejtoritë e INSTAT-it, në lidhje me diskutimet rreth tre rezultateve për zbatimin e fazës II të projektit SALSTAT (2022-2026). Nga ekipi FSO ishin të pranishëm Z. Martin Teichgräber dhe Z. Werner Haug. Gjithashtu, gjatë seminarit u organizua një shkëmbim me Helvetas për të diskutuar sinergjitë ndërmjet dy projekteve.

Në datën 10 Mars, në ambientet e INSTAT-it u zhvillua takimi përmbyllës me pjesëmarrjen e znj. Elda Bagaviki nga Ambasada Zvicerane në Shqipëri. Në këtë takim u prezantuan gjetjet e seminarit dhe diskutimet u përqendruan në objektivat, produktet dhe aktivitetet e fazës II (2022-2026).



Trajnimet e ardhshme për vitin 2022

SALSTAT/INSTAT planifikon të vazhdojë trajnimet e tjera të parashikuara mbi statistikat zyrtare të bashkive dhe zyrave rajonale statistikore, dhe konkretisht gjatë muajve të ardhshëm të vitit 2022 do të zhvillohen këto trajnime:

- Workshop me Zyrat Rajonale Statistikore, në datat 14-15 prill 2022
- Programi i avancuar i Microsoft Excel për stafin e bashkive, gjatë datave 19 prill - 30 maj 2022
- Anketa e bazuar në internet mbi trajnimin për menaxhimin e mbetjeve shtëpiake për stafin e bashkive dhe drejtuesit e Zyrave Rajonale Statistikore, gjatë datave 05 – 12 maj 2022.
- Analiza e të Dhënave Statistikore me stafin e bashkive gjatë muajit qershor 2022
- Trajnim me stafin e Zyrave të Gjendjes Civile për përmirësimin e statistikave jetësore gjatë muajit korrik 2022

FALEMINDERIT NGA EKIPI SALSTAT!

Menaxher projekti:

Martin Teichgräber, Zyra Federale Zvicerane e Statistikave

Koordinatorë:

Eralda Pushaj, Koordinatore me Njësitë e Qeverisjes Qendrore

Edlira Çeliku, Koordinatore Administrative dhe Financiare

Alketa Doçi, Koordinatore për Regjistrat dhe të Dhënat Administrative

Instituti i Statistikave - Tiranë

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017

Email: info@instat.gov.al

Telefon: +355 (4) 2233356 / 2233358